

Data __.__.2025

PROCESVERBAL

**PËR MOS-NDARJEN NË LOTE TË PROCEDURËS SË HAPUR MBI KUFIRIN E
LARTË MONETAR**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI : Evadim i mbetjeve te rrezikshme spitalore ,per nevoja te SRV – Mareveshje Kuader me nje operator ekonomik -ku te gjitha kushtet jane te percaktuara -me afat 4 vjecar (48 muaj) .

FOND LIMIT : 36 258 665 (tridhjetë e gjashtë miliona e dyqind e pesëdhjetë e tetemije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pese) leke pa tvsh, e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 29/07/2025 është 353'667 (treqind e pesëdhjetë e tre mije e gjashtëqind e gjashtë dhjetë e shtate) euro pa tvsh

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 29/07/2025 (97.54 lekë/euro).

REF-56701-07-30-2025

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Mbledhja ,transporti dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore - 90524400-0

Në bazë të nenit 39, pika 1, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c, autoriteti/enti kontraktor dhe nenit 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, parashikohet se:

[...]1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale. [...]

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se ka hartuar procesverbalin për për mos-ndarjen në lote të procedurës së Hapur mbi kufirin e lartë monetar, me arsyetimin si më poshtë:

1. Procedura e prokurimit është shërbim specifik me objekt Mbledhjen, transportin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore per te cilat kerkohen licenca specifike, investime te konsiderueshme ne teknologji, pajisje, makineri dhe ne njerez per te cilat mund te ofertoehen vetem nje numer i kufizuar operatoresh ekonomike ne tregun shqiptar.

Nuk mund të ndahet në lote pasi ndarja në lote sipas kodeve të mbetjeve mund të çojë në dështimin e lotëve për të cilat sasia apo vlera e parashikuar është e ulët dhe nuk justifikon investimin apo kostot e nevojshme për të trejtuar ato kode mbetjesh.

2. Nga eksperiencia e Ak në kryerjen e këtij shërbimi rezulton se numri i OE është i kufizuar në tregun shqipëtar dhe për nga rëndësia që ka procesi i trajtimit të mnetjeve, OE duhet të kenë investuar në sigurimin e makinerive/paisjeve që mundësojnë këtë shërbim.

3. Ndarja në lote do të krijonte konfuzion tek OE pjesmarrës dhe kosto shtesë për AK në kryerjen procedurave të prokurimit dhe në zbatimin e kontratave të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore.

4. Autoriteti Kontraktor nuk ka parashikuar Sasi orientuese për çdo kod, duke qenë se nga eksperincat e mëparshme kanë hasur vështirësi gjatë zbatimit të kontratës për çdo kod dhe ndarja në lote do të krijonte vështirësi.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara në DST janë gjithëpërfshirëse, që u jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për të bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.

Njësia e Prokurimit: